



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
DREJTORIA EKONOMIKE, BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RELACION

PËR MONITORIMIN E BUXHETIT PERIUDHA JANAR – DHJETOR 2024

2. Hyrje

Misioni i Gjykatës Kushtetuese është garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimit përfundimtar të saj. Gjykata Kushtetuese si një organ kushtetues i pavarur kontribuon për forcimin e shtetit të së drejtës, nëpërmjet vendimmarrjes për ndërtimin e një shteti të lirë, demokratik e paqedashës, duke garantuar respektimin e të drejtave kushtetuese të çdo shtetasi, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese në konfliktin e kompetencave ndërmjet pushteteve, pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën, pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, kushtetueshmërinë e partive, organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre.

Buxheti i akorduar për programin 03320, “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP), të hartuar gjatë procesit të PBA 2024-2026 dhe të miratuar për buxhetin e vitit 2024. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim realizimin e një procesi gjyqësor të pavarur, transparent në mbrojtje të kushtetutës dhe të drejtave themelore të njeriut nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës ndërtimore, elektronike dhe kushteve të punës të gjykatës për krijimin e kushteve optimale të punës e sigurisë për gjyqtarët dhe administratën.

Programi konsiston në mbështetjen buxhetore nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve e aktiviteteve buxhetore për mbështetjen e shërbimeve gjyqësore ndaj publikut me përmirësimin e infrastukturës së gjykatës dhe plotësimin e nevojave për mallra e shërbime.

3. Informacion buxhetor i agreguar

Gjatë 12- mujorit të periudhës raportuese, me shkresën Nr. 219 Prot., datë 13.02.2024 është kërkuar çelja e fondit të veçantë në zbatim të tabelës 1, të Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, i cili është miratuar dhe detajuar me shkresën e MF, nr. 1745/1 prot., datë 26.02.2024.

Në këtë periudhë, është kërkuar edhe rialokim fondi nga llogaria 602 në llogarinë 606 me shkresën Nr.648 Prot., datë 17.07.2024 në shumën 272,000 Lekë për kompensimin e funksionarëve përfitues të telefonisë celulare sipas pikës 5 të Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, dhe kërkesa është miratuar me shkresën Nr. 10094/1 Prot, datë 29.07.2024, protokolluar në Gjykatën Kushtetuese me Nr.648/1 Prot., datë 31.07.2024. Për arsye të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë për një punonjës të institucionit, është kërkuar një shtesë prej 145,000 lekësh në fondin e veçantë, e cila është miratuar nga ana e MF me shkresën e tyre Nr. 10602/1 Prot, datë 13.08.2024.

Gjithashtu, për nevoja të institucionit dhe me qëllimin kryesor realizimin e produkteve të parashikuar, si dhe përdorimin sa më eficient të fondeve buxhetore janë kërkuar disa rialokime në zërin Investime Kapitale (Art. 231), të cilat janë miratuar nga ana e Ministrisë së Financave.

Me Aktit Normativ Nr.5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, janë akorduar 30 milion për diferencën e pagës së gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë, për periudhën 01 janar 2019 - 08 janar 2023.

Përveç këtij fondi, gjatë vitit 2024, bazuar në kërkesat e Gjykatës Kushtetuese, janë kryer disa akordime dhe rialokime fondesh në lidhje me shpenzimet korrente.

Në mënyrë të detajuar shtesat/pakësimet e buxhetit për vitin 2024 në lidhje me shpenzimet korrente, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

	<i>Në lekë</i>
Buxheti fillestar	244,300,000
Akordim fondesh shtesë gjatë vitit 2024 në llog 600 - Paga	+53,150,000
Pakësim fondi gjatë vitit 2024 në llog 601 - Sigurime	-50,000
Akordim fondi shtesë gjatë vitit 2024 në llog 602- Shpenzime operative	+6,228,000
Akordim fondi shtesë gjatë vitit 2024 në llog 606 – Fond i veçantë	+1,718,396
Buxheti pas shtesave gjatë vitit 2024	305,346,396

Buxheti final i vitit 2024 prej 305,346,396 lekësh, në krahasim me buxhetin final të vitit 2023 prej 173,408,262 lekësh , ka një rritje +131,938,134 lekësh (ose +43%).

Numri i punonjësve buxhetor i miratuar nga Ministria e Financave është 68 punonjës plus 2 punonjës (specialistë) me kontratë. Numri faktik i punonjësve të Gjykatës Kushtetuese në fund të periudhës raportuese është 67 punonjës (42 punonjëse femra dhe 26 punonjës meshkuj).

4.Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti

5.Perfomancë e buxhetit në nivel programi

Kodi i Programit: 03320

Emërtimi i programit: “Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”

Qëllimet e Politikës së Programit:

Realizimi i veprimtarisë gjyqësore kushtetuese për garantimin e respektimit të Kushtetutës dhe interpretimit përfundimtar të saj, zgjidhja e mosmarrëveshjeve kushtetuese, në lidhje me ndarjen e pushteteve, ankesat e individëve, lidhur me cënimin e të drejtave kushtetuese, etj. nëpërmjet një procesi të drejtë ligjor dhe transparent.

Përshkrimi i programit: Realizimi i proceseve gjyqësore të drejta dhe të hapura në mbrojtje të kushtetutës dhe lirive e të drejtave themelore të njeriut.

Veprimtaria gjyqësore kushtetuese është programi buxhetor i përbërë nga produktet:

- 93001AA Produkti "Vendime të marra",** nga 400 vendime (pas rishikimit) të planifikuara për vitin 2024, janë realizuar 408 vendime për periudhën 12-mujore, ky produkt është realizuar 100 %.
- M300003 Produkti “Automjete”,** nga 5 automjete të planifikuara për t’u blerë gjatë vitit 2024, janë blerë 5 (pesë) automjete, ky produkt është realizuar 100 %.
- M300004 Produkti “Paisje zyre”,** është i ndarë në mobilje dhe orendi dhe paisje elektrike zyre (kondicioner, tv, etj.). Gjatë 12-mujorit të vitit 2024 është realizuar në përputhje me parashikimin, Diferenca e fondit të mbetur është si rezultat i procedurave të prokurimit.

- M300008** **Produkti “Rikonstruksion”** është realizuar në përputhje me kontratën.
- I8AG003** **Produkti “Informatizim i veprimtarisë”** është realizuar dhe diferenca e fondit të mbëtur vjen si rezultat i procedurave të prokurimit.
- M300007** **Produkti “Biblioteka”,** nga 20 tituj të planifikuar për t’u blerë, janë blerë 10 tituj.

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik janë si më poshtë:

Për artikullin 600- “Paga”, me financim nga buxheti i shtetit fondi është realizuar në masën 99.9% për periudhën janar-dhjetor 2024

Për artikullin 601- Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, fondi i akorduar është realizuar në masën 99.3% për periudhën janar-dhjetor 2024.

Për artikullin 602- Shpenzime operative, realizimi për këtë zë është në masën 93.7%. Në këtë zë është akorduar nga MF në muajin dhjetor 2024, fondi prej 3,500,000 lekë, fond i cili nuk është kërkuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Artikulli 605-Shpenzime për transferta korrente të huaja (605) nga 1,000,000 lekë të akorduara për vitin 2024 dhe janë shpenzuar 641,195 lekë:

1. Kontributi financiar vjetorë për Konferencën Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (WCCJ) në vlerën 105,500 lekë.
2. Kuotizacioni vjetor që paguan gjykata si anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Gjykatave Kushtetuese Fronkofone (ACCF) në vlerën 242,891 lekë.
3. Kontributi financiar për pjesëmarrjen në Konferencën e Gjykatave Kushtetuese Evropiane në vlerën 292,804 lekë.

Artikulli 606- Shpenzime për transferta të brendshme, nga 1,718,396 lekë, janë shpenzuar 1,718,066 lekë, me një diferencë prej 330 lekë, për rimbursimet e shpenzimeve telefonike, pagesë për dalje në pension të një punonjësi, pagesë për largimin nga funksioni të një gjyqtari, pagesë për ndihmë të menjëhershme të punonjësve mbështetës sipas VKM nr.846, datë 26.12.2024 "Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore." Realizimi i artikullit 606 - Shpenzime për transferta të brendshme është në masën 100%

6. Projektet kapitale –Investime kapitale

Fondi total i akorduar nga buxheti i vitit 2024, për investimet kapitale është 35,000,000 lekë. Në këtë fond janë të përfshira investimet për të gjitha produktet e parashikuara për t'u realizuar gjatë vitit 2024 nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Këtu përfshihen investimet që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës së brendshme të gjykatës, informatizimin e veprimtarisë, pasurimin e bibliotekës me tituj profesionalë, etj. Gjatë kësaj periudhe janë kryer ndryshime (*rialokime fondesh*), brenda fondit të miratuar, me qëllim maksimizimin e realizimit të produkteve të parashikuara. Këto ndryshime kanë marrë edhe miratimin e Ministrisë së Financave.

Realizimi i “Projekteve kapitale –Investime kapitale” – llog 231, për vitin 2024 është në shumën 33,684,145 lekë ose në masën 96.2%.

Në zërin investime kapitale, 5 -produktet janë realizuar sipas parashikimeve dhe nuk është e nevojshme të ndërmerren masa korigjuese.

7. Ndryshimet në buxhet:

Zëri “**Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore (600-601)**”, për numrin e përgjithshëm prej 68 punonjës në organikë është përlllogaritur nga Ministria e Financave (MF) në total 165,800,000 lekë, nga të cilat 146,500,000 lekë është fondi për paga, ndërsa 19,300,000 lekë është fondi për sigurimet shoqërore. Nga përlllogaritjet e kryera nga Drejtoria Ekonomike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse rezultoi që fondi i akorduar nga MF nuk ishte i mjaftueshëm për mbulimin e pagave të punonjësve të gjykatës deri në fund të vitit 2024. Për këtë arsye, u zhvillua një takim në drejtorinë e Buxhetit në MF, nga ku rezultoi që fondi për mbulimin e shpenzimeve të pagave dhe sigurimeve shoqërore për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 duhet të jetë 181,278,000 i ndarë në 163,017,000 lekë fond pagash dhe 18,261,000 lekë fond për sigurime shoqërore. Sa më sipër rezulton një diferencë prej -15,478,000 lekë (*paga -16,517,000 lekë dhe sigurime shoqërore +1,039,000 lekë*). Me drejtorinë e Buxhetit në MF u dakortësua që kjo shtesë do të kërkohej nga ana jonë me një shkresë zyrtare të veçantë drejtuar MF. Gjykata Kushtetuese ju drejtua MF me shkresën nr. 186 prot., datë 05.02.2024, me anë të së

cilës i kërkon MF shtesën e dakortësuar (në shumën 15,500,000 lekë) nga rakordimi midis dy institucioneve. Kjo shtesë u akordua me anë të Aktit Normativ nr. 3, datë 28.08.2024.

Gjithashtu, me Aktit Normativ Nr.5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, janë akorduar 30,000,000 lekë, për diferencën e pagës së gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë, për periudhën 01 janar 2019 - 08 janar 2023.

Buxheti total i rishikuar për vitin 2024 (përshirë shtesat,rialokimet) për paga - llog. 600 është 199,650,000 lekë dhe për fondi për sigurime - llog 601 është në shumën prej 19,250,000 lekë.

8. Përfundimet:

Performanca financiare e institucionit paraqitet shumë e mirë dhe në përputhje me parashikimet e bëra gjatë vitit. Gjatë periudhës raportuese nuk janë evidentuar faktorë të jashtëm ose të brendshëm të cilët mund të kenë ndikim thelbësor në arritjen e objektivave të vendosura dhe realizimin e produkteve në përputhje me programin “Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

EUGEN PAPANDILE